

**DERI TE:
KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR
FAKULTETI I SHKENCAVE TË
ZBATUARA**

REFERAT I KOMISIONIT RECENZUES

PËR ZGJEDHJEN E MËSIMDHËNËSIT NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE PËR LËNDËT NË LËMINË E ARKITEKTURËS, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË ZBATUARA TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Në bazë të konkursit nga Universiteti i Tetovës për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore dhe në thirrjet e bashkëpunëtorëve, të shpallur më 03.12.2020 në shtypin ditor “Koha” dhe “Sloboden Peçat” si dhe në web-faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, Këshilli Mësimor-shkencor i Fakultetit të Shkencave të Zbatuara, në mbledhjen e mbajtur më datë **11.12.2020**, solli Vendimin nr. **17- 895/3** për formimin e Komisionit recenzues në përbërje:

1. **Prof. Dr. Kujtim Elezi, kryetar**, Profesor ordinar, Fakulteti i Shkencave të Zbatuara, Universiteti i Tetovës, Tetovë, Prodekan për Shkencë, Republika e Maqedonisë së Veriut.
2. **Prof. Dr. Violeta Nushi, anëtar**, Profesor ordinar, Fakulteti i Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, Dekan, Kosovë.
3. **Doc. Dr. Nuran Saliu, anëtar**, Docent, Fakulteti i Shkencave të Zbatuara, Universiteti i Tetovës, Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni recensues, në përbërje si më sipër, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, titujve të nderuar u paraqet këtë:

R A P O R T

Në Konkursin e shpallur më datë 03.12.2020 në shtypin ditor “Koha” dhe “Sloboden Peçat” si dhe në web-faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës është paraqitur vetëm 1 (një) kandidat, **Dr. sc. Lindihana Goxha**, bashkëpunëtoresh part-time në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara të Universitetit të Tetovës. Bashkangjitur me fletë-aplikimin, ka dorëzuar të gjithë dokumentet e nevojshme sipas Konkursit të shpallur.

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

I.1 Shënime biografike

Emri dhe mbiemri	Lindihana Goxha
Datëlindja	13.06.1978
Vendlindja	Shkup, R.M.V
Adresa e banimit	Rr."Ilindenska" nr.91/1, Gostivar
Nënshtetësia	Republika e Maqedonisë së Veriut
Telefoni	070 260 777
E-maili	lindihana.goxha@unite.edu.mk
Thirrja shkencore	Doktor i Shkencave Teknike

I.2 Arsimimi dhe kualifikimi

I.2.1. Arsimi i mesëm	
Shkolla e mesme	Gjimnazi „Pance Poposki” - Gostivar
Drejtimi	Matematiko – natyror
Viti	1996/1997
Suksesi	Shkëlqyeshëm
I.2.2. Studimet themelore	
Universiteti	Universiteti „MIT”- Shkup
Fakulteti	Fakulteti i Arkitekturës
Titulli i fituar	Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës
Viti i përfundimit të studimeve	2020
Universiteti	Universiteti „Shën Kirili dhe Metodij”-
Fakulteti	Fakulteti i Arkitekturës,
Titulli i fituar	Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës, shkalla VII/1
Viti i përfundimit të studimeve	2006
I.2.3. Studimet e Magjistraturës	
Universiteti	Universiteti „Shën Kirili dhe Metodij”- Shkup
Fakulteti	Fakulteti i Ndërtimtarisë
Titulli i fituar	Magjistër i shkencave Teknike
Viti i përfundimit të studimeve	2012
I.2.4. Doktoratura	
Universiteti	Universiteti i Zagrebit
Fakulteti	Fakulteti i Arkitekturës
Titulli i fituar	Doktor i shkencave teknike, Dr.Sc
Viti i përfundimit të studimeve	2018

I.3 Përvoja profesionale

Viti	Qershor 2007 – Dhjetor 2007
Emri dhe adresa e institucionit-punëdhënësit	Komuna e Vrapçishtit, Sektori i Urbanizmit, Fshati Negotinë e Pollogut
Detyrat e punës	Bashkëpunëtor
Viti	Janar 2008 – vazhdon
Emri dhe adresa e institucionit-punëdhënësit	Shkolla e Mesme Teknike „Gostivar”, Gostivar, RMV
Detyrat e punës	Mësimdhënës i lëndëve profesionale- Arkitekturë

Viti	Nëntor 2008 – vazhdon
Emri dhe adresa e institucionit-punëdhënësit	Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Shkencave të Zbatuara, Tetovë
Detyrat e punës	Mësimdhënës
Viti	2009 – 2018
Emri dhe adresa e institucionit-punëdhënësit	„Votra- Ing” SHPK, Gostivar
Detyrat e punës	Projektant përgjegjës i autorizuar

I.4 Përvoja pedagogjike -Akademike

Viti	2008-2014
Emri i Institucionit	Universiteti i Tetovës – Fakulteti i Shkencave të Zbatuara
Detyrat e punës	Mësimdhënës - Asistent
Programi studimor	Arkitekturë
Lëndët	<ul style="list-style-type: none"> - Analiza Tredimensionale e Formës - Inçizimi dhe Mirëmbajtje e ndërtesave - Konstruksione Arkitektonike 1 - Konstruksione Arkitektonike 2 - Fizika dhe Ekologjia e Ndërtimit
Viti	2014-2017
Emri i Institucionit	Universiteti i Tetovës – Fakulteti i Shkencave të Zbatuara
Detyrat e punës	Mësimdhënës
Programi studimor	Arkitekturë
Lëndët	<ul style="list-style-type: none"> - Fizika Arkitektonike 1 - Konstruksionet Arkitektonike IA - Konstruksionet Arkitektonike IIA - Fizika Arkitektonike 2 - Fizika Ndërtimore - Analiza e Formës
Viti	2018-2019
Emri i Institucionit	Universiteti i Tetovës – Fakulteti i Shkencave të Zbatuara
Detyrat e punës	Mësimdhënës
Programi studimor	Arkitekturë
Lëndët	<ul style="list-style-type: none"> - Fizika Arkitektonike 1 - Fizika Arkitektonike 2 - Fizika Ndërtimore - Analiza e Formës - Konstruksionet Bashkëkohore të mbulesave
Viti	2019-2020
Emri i Institucionit	Universiteti i Tetovës – Fakulteti i Shkencave të Zbatuara
Detyrat e punës	Mësimdhënës
Programi studimor	Arkitekturë

Lëndët	<ul style="list-style-type: none"> - Elementet e Projektimit - Bazat e Projektimit - Fizika Arkitektonike 1 - Fizika Arkitektonike 2 - Fizika Ndërtimore - Analiza e Formës
--------	---

II. VEPRIMTARIA ARIMORE - SHKENCORE

II.1 Veprimtaria arsimore- mësimore

Kandidatja, **Dr.sc. Lindihana Goxha**, veprimtarinë e saj arsimore- mësimore e ka zhvilluar në mbajtjen e ligjëratave si doktorant, ushtrimeve dhe konsultimeve në ciklin e parë të studimeve në Programin studimor: Arkitekturë, në këto lëndë mësimore:

II.1.1. Programi studimor: Arkitekturë

II.1.1.1 Cikli i parë i studimeve: Analiza Tredimensionale e Formës, Inçizimi dhe Mirëmbajtja e Objekteve, Konstruksionet Arkitektonike 1, Konstruksionet Arkitektonike 2, Fizika dhe Ekologjia e Ndërtimit në akreditimin e viteve 2007-2013, si dhe lëndët Fizika Arkitektonike 1, Konstruksionet Arkitektonike IA, Konstruksionet Arkitektonike IIA, Fizika Arkitektonike 2, Analiza e Formës, Elementet e Projektimit dhe Bazat e projektimit në akreditimin aktual.

II.1.2. Programi studimor: Ndërtimtari

II.1.2.1 Cikli i parë i studimeve: Fizika Ndërtimore dhe Konstruksionet Bashkëkohore të ndërtesave në akreditimin aktual.

II.1.3. Kandidatja, **Dr.sc. Lindihana Goxha**, në evaluimin e realizuar në vitin shkollor 2013/2014 dhe 2017/2018, është vlerësuar pozitivisht nga anketa anonime e studentëve të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara, të Universitetit të Tetovës.

Plotësim: Veprimtaria e detajuar mësimore-arsimore, prezantohet në **Shtojcën I** të këtij Raporti.

II.2 Veprimtaria shkencore- hulumtuese

Kandidatja, **Dr.sc. Lindihana Goxha**, veprimtarinë shkencore-hulumtuese e ka zhvilluar në:

II.2.1. Publikimin e punimeve shkencore me rezultate origjinale shkencore, në Revista shkencore- profesionale referente me Këshill redaktues ndërkombëtar, 7 (shtatë) punime.

II.2.2. Pjesëmarrjen në takime shkencore- profesionale me referat- Prezantime orale, 2 (dy).

II.2.3. Abstrakte të publikuar në Përmbledhje të konferencave ndërkombëtare, 5 (pesë).

Plotësim: Veprimtaria e detajuar shkencore-hulumtuese, prezantohet në **Shtojcën II** të këtij Raporti.

II.3 Veprimtaria profesionale- aplikative

Kandidatja, **Dr.sc. Lindihana Goxha**, veprimtarinë profesionale- aplikative e ka zhvilluar si vijon:

II.3.1. Disa punime të botuara të kandidatës, **Dr.sc. Lindihana Goxha**, 2 (dy) herë citohen në punime shkencore të botuara në Revista shkencore ndërkombëtare, punime

magjistature ose doktorature.

II.3.2. Projekte Ideore dhe Themelore Arkitektonike si projektant përgjegjës i autorizuar

Plotësim: Veprimtaria e detajuar profesionale-aplikative, prezantohet në **Shtojcën III** të këtij Raporti.

II.4 Veprimtaria me interes më të gjërë

Në bazë të dokumentacionit të prezantuar, kandidatja **Dr.sc. Lindihana Goxha** realizon edhe veprimtari me interes më të gjërë si vijon:

II.4.1. Anëtar i Këshillit Organizativ i Konferencës së parë, dytë dhe të pestë Ndërkombëtare të organizuar nga FSHZ, Tetovë, 2015, 2016, 2019.

II.4.2. Anëtar i Dhomës së Arkitektëve dhe Inxhinjerëve të Maqedonisë së Veriut.

II.4.3. Anëtar i Bordit Shkencor i revistës ndërkombëtare JAS-SUT – viti 2020.

Plotësim: Veprimtaria e detajuar me interes më të gjerë, prezantohet në **Shtojcën IV** të këtij Raporti.

III. PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar dhe në bazë të njohjes personale të kandidatës, konkludohet qartë se **Dr.sc. Lindihana Goxha**, në një periudhë kohore prej afër 13 vitesh të pandërprerë ka ushtruar me kompetencë veprimtarinë e mësimdhënies dhe veprimtarinë shkencore-hulumtuese pranë Fakultetit të Shkencave të Zbatuara, Programi studimor Arkitekturë. Paraqitja në Konkursin e shpallur për t'u avancuar në thirrje mësimore-shkencore në lëndët në fushën e Arkitekturës, tregon qartë përkushtimin dhe angazhimin e mëtejshëm të saj në veprimtarinë e mësimdhënies, në zhvillimin e veprimtarisë shkencore-hulumtuese, profesionale dhe pedagogjike në këtë fushë shkencore.

Bazuar në nenin 14 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore- shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, përkatësisht në nenin 125 të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kandidatja **Dr.sc. Lindihana Goxha**:

- 1. Ka gradën e doktorit të shkencave teknike,**
- 2. Ka publikuar numrin e nevojshëm të punimeve me rezultate origjinale shkencore në Revista shkencore-profesionale referente me këshill redaktues ndërkombëtar, përkatësisht në publikime shkencore ndërkombëtare, disa prej të cilëve citohen në Revista shkencore ndërkombëtare;**
- 3. Ka shfaqur aftësi për zbatimin e veprimtarisë arsimore-mësimore, veprimtarisë shkencore-hulumtuese, veprimtarisë profesionale-aplikative dhe veprimtarisë me interes më të gjerë dhe ka kontribuar në shkollimin dhe aftësimin e kuadrove të reja nga fusha e shkencave teknike;**
- 4. Është vlerësuar pozitivisht, në evaluimin e zbatuar në vitin shkollor 2013/2014 dhe 2017/2018, nga anketa anonime e studentëve të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara, të Universitetit të Tetovës.**


PROPOZIM


Duke e vlerësuar veprimtarinë mësimore-arsimore, veprimtarinë shkencore-hulumtuese, veprimtarinë profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes më të gjerë, të kandidatës **Dr.sc. Lindihana Goxha**, duke e marrë parasysh përkushtimin e saj të pandërprerë për ngritje dhe zhvillim të mëtejshëm të veprimtarisë profesionale, shkencore dhe pedagogjike, **Komisioni Recensues** konstaton se kandidatja **Dr.sc. Lindihana Goxha**, i plotëson kriteret e specifikuar për zgjedhje në thirrjen mësimore-shkencore **Docent**, sipas nenit 14 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, përkatësisht nenit 125 të Ligjit për Arsimin e Lartë të R.M.V-së, pasi që ka realizuar gjithsejtë **137.07 pikë** - për veprimtarinë arsimore-mësimore, gjithsejtë **44.70 pikë** - për veprimtarinë shkencore-hulumtuese, gjithsejtë **138.00 pikë** - për veprimtarinë profesionale-aplikative dhe gjithsejtë **13.00 pikë** - për veprimtarinë me interes më të gjerë, që në total japin shumën e përgjithshme **332.77 pikëve**.


Prandaj, Komisioni vlerësues ka nderin dhe kënaqësinë e veçantë t'i **PROPOZOJË** këshillit- mësimor shkencor të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara, që kandidatja **Dr.sc. Lindihana Goxha** të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **DOCENT** për lëndët në fushën e Arkitekturës.

Tetovë, 14.12.2020

KOMISIONI RECENZUES:

1. Prof. Dr. Kujtim Elezi, kryetar 
(Universiteti i Tetovës, FSHZ, Prodekan për shkencë, R.M.V)

2. Prof. Dr. Violeta Nushi, anëtar 
(Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Arkitekturës, Dekan, Kosovë)

3. Doc. Dr. Nuran Saliu, anëtar 
(Universiteti i Tetovës, FSHZ, R.M.V)

SHTOJCA

PËR RAPORTIN E RECENSIONIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE MËSIMORE- SHKENCORE, SHKENCORE DHE SHKENCORE PROFESIONALE

Kandidatja: **Dr.sc. Lindihana Goxha**

Institucioni: Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Shkencave të

Zbatuara Lëndët nga fusha e Arkitekturës

I. VEPRIMTARIA MËSIMORE- ARSIMORE

Nr.Ren.	Emërtimi i aktivitetit	Pikët	Fondi orëve	Javë	Gjithsejt
I.1.	Mbajtja e mësimit në ciklin e I^{rë} të studimeve, Programi studimor: Arkitekturë				
I.1.1	Viti akademik 2008/2009 (semestri dimëror dhe veror)				
	<i>Analiza Tredimensionale e Formës</i>	0.03	6	15	2.70
	<i>Konstruksionet Arkitektonike 1</i>	0.03	4	15	1.80
I.1.2	Viti akademik 2009/2010 (semestri dimëror & veror)				
	<i>Analiza Tredimensionale e Formës</i>	0.03	6	15	2.70
	<i>Konstruksionet Arkitektonike 1</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Konstruksionet Arkitektonike 2</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Inçizimi dhe mirëmbajtja e objekteve</i>	0.03	4	15	1.80
I.1.3	Viti akademik 2010/2011 (semestri dimëror & veror)				
	<i>Analiza Tredimensionale e Formës</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Analiza Tredimensionale e Formës</i>	0.03	6	15	2.70
	<i>Konstruksionet Arkitektonike 1</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Konstruksionet Arkitektonike 2</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Inçizimi dhe mirëmbajtja e objekteve</i>	0.03	4	15	1.80
I.1.4	Viti akademik 2011/2012 (semestri dimëror & veror)				
	<i>Analiza Tredimensionale e Formës</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Analiza Tredimensionale e Formës</i>	0.03	6	15	2.70
	<i>Konstruksionet Arkitektonike 1</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Konstruksionet Arkitektonike 2</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Inçizimi dhe mirëmbajtja e objekteve</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Fizika dhe Ekologjia e Ndërtimit</i>	0.03	4	15	1.80
I.1.5	Viti akademik 2012/2013 (semestri dimëror & veror)				
	<i>Analiza Tredimensionale e Formës</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Analiza Tredimensionale e Formës</i>	0.03	6	15	2.70
	<i>Konstruksionet Arkitektonike 1</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Konstruksionet Arkitektonike 2</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Fizika dhe Ekologjia e Ndërtimit</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika dhe Ekologjia e Ndërtimit</i>	0.03	4	15	1.80
I.1.6	Viti akademik 2013/2014 (semestri dimëror & veror)				
	<i>Analiza Tredimensionale e Formës</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Analiza Tredimensionale e Formës</i>	0.03	6	15	2.70
	<i>Konstruksionet Arkitektonike 1</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Konstruksionet Arkitektonike 2</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Fizika dhe Ekologjia e Ndërtimit</i>	0.04	2	15	1.20

	<i>Fizika dhe Ekologjia e Ndërtimit</i>	0.03	4	15	1.80
I.1.7	Viti akademik 2014/2015 (semestri dimëror&veror)				
	<i>Konstruksionet Arkitektonike 2A</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Fizika Arkitektonike 1</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Arkitektonike 1</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Fizika Arkitektonike 2</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Arkitektonike 2</i>	0.03	2	15	0.90
	<i>Analiza e Formës</i>	0.04	1	15	0.60
	<i>Analiza e Formës</i>	0.03	4	15	1.80
I.1.8	Viti akademik 2015/2016 (semestri dimëror&veror)				
	<i>Konstruksionet Arkitektonike 1A</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Fizika Arkitektonike 1</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Arkitektonike 1</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Fizika Arkitektonike 2</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Arkitektonike 2</i>	0.03	2	15	0.90
	<i>Analiza e Formës</i>	0.04	1	15	0.60
	<i>Analiza e Formës</i>	0.03	4	15	1.80
I.1.9	Viti akademik 2016/2017 (semestri dimëror&veror)				
	<i>Fizika Ndërtimore</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Ndërtimore</i>	0.03	2	15	0.90
	<i>Fizika Arkitektonike 1</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Arkitektonike 1</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Fizika Arkitektonike 2</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Arkitektonike 2</i>	0.03	2	15	0.90
	<i>Analiza e Formës</i>	0.04	1	15	0.60
	<i>Analiza e Formës</i>	0.03	4	15	1.80
I.1.10	Viti akademik 2017/2018 (semestri dimëror&veror)				
	<i>Fizika Ndërtimore</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Ndërtimore</i>	0.03	2	15	0.90
	<i>Fizika Arkitektonike 1</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Arkitektonike 1</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Fizika Arkitektonike 2</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Arkitektonike 2</i>	0.03	2	15	0.90
	<i>Analiza e Formës</i>	0.04	1	15	0.60
	<i>Analiza e Formës</i>	0.03	4	15	1.80
I.1.11	Viti akademik 2018/2019 (semestri dimëror&veror)				
	<i>Fizika Ndërtimore</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Ndërtimore</i>	0.03	2	15	0.90
	<i>Fizika Arkitektonike 1</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Arkitektonike 1</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Fizika Arkitektonike 2</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Arkitektonike 2</i>	0.03	2	15	0.90
	<i>Analiza e Formës</i>	0.04	1	15	0.60
	<i>Analiza e Formës</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Konstruksionet Bashkëkohore të Mbulesave</i>	0.03	2	15	0.90
I.1.12	Viti akademik 2019/2020 (semestri dimëror&veror)				
	<i>Elementet e Projektimit</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Ndërtimore</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Ndërtimore</i>	0.03	2	15	0.90
	<i>Fizika Arkitektonike 1</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Arkitektonike 1</i>	0.03	4	15	1.80
	<i>Bazat e Projektimit</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Arkitektonike 2</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Arkitektonike 2</i>	0.03	2	15	0.90
	<i>Analiza e Formës</i>	0.04	1	15	0.60
	<i>Analiza e Formës</i>	0.03	4	15	1.80
I.1.13	Viti akademik 2020/2021 (semestri dimëror)				
	<i>Elementet e Projektimit</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Ndërtimore</i>	0.04	2	15	1.20

	<i>Fizika Ndërtimore</i>	0.03	2	15	0.90
	<i>Fizika Arkitektonike I</i>	0.04	2	15	1.20
	<i>Fizika Arkitektonike I</i>	0.03	4	15	1.80
I.2	Konsultime me studentët, Programi studimor: Arkitekturë				
I.2.1	Viti akademik 2008/2009				
	<i>Semestri dimëror</i>	0.002		80 studentë	0.16
	<i>Semestri veror</i>	0.002		70 studentë	0.14
I.2.2	Viti akademik 2009/2010				
	<i>Semestri dimëror</i>	0.002		60 studentë	0.12
	<i>Semestri veror</i>	0.002		70 studentë	0.14
I.2.3	Viti akademik 2010/2011				
	<i>Semestri dimëror</i>	0.002		65 studentë	0.13
	<i>Semestri veror</i>	0.002		60 studentë	0.12
I.2.4	Viti akademik 2011/2012				
	<i>Semestri dimëror</i>	0.002		70 studentë	0.14
	<i>Semestri veror</i>	0.002		60 studentë	0.12
I.2.5	Viti akademik 2012/2013				
	<i>Semestri dimëror</i>	0.002		80 studentë	0.16
	<i>Semestri veror</i>	0.002		60	0.12
I.2.6	Viti akademik 2013/2014				
	<i>Semestri dimëror</i>	0.002		60 studentë	0.12
	<i>Semestri veror</i>	0.002		70 studentë	0.14
I.2.7	Viti akademik 2014/2015				
	<i>Semestri dimëror</i>	0.002		60 studentë	0.12
	<i>Semestri veror</i>	0.002		50 studentë	0.10
I.2.8	Viti akademik 2015/2016				
	<i>Semestri dimëror</i>	0.002		60 studentë	0.12
	<i>Semestri veror</i>	0.002		60 studentë	0.12
I.2.9	Viti akademik 2016/2017				
	<i>Semestri dimëror</i>	0.002		70 studentë	0.14
	<i>Semestri veror</i>	0.002		60 studentë	0.12
I.2.10	Viti akademik 2017/2018				
	<i>Semestri dimëror</i>	0.002		50 studentë	0.10
	<i>Semestri veror</i>	0.002		40 studentë	0.08
I.2.11	Viti akademik 2018/2019				
	<i>Semestri dimëror</i>	0.002		60 studentë	0.12
	<i>Semestri veror</i>	0.002		60 studentë	0.12
I.2.12	Viti akademik 2019/2020				
	<i>Semestri dimëror</i>	0.002		40 studentë	0.08
	<i>Semestri veror</i>	0.002		30 studentë	0.06
I.2.13	Viti akademik 2020/2021				
	<i>Semestri dimëror</i>	0.002		40 studentë	0.08
I.3	Përgatitja e lëndës së re mësimore				
I.3.1	Semestri dimëror-ligjërata	1	3 lëndë	3.00	3.00
I.3.2	Semestri dimëror-ushtrime	1.5	2 lëndë	3.00	3.00
I.3.3	Semestri veror-ligjërata	1	3 lëndë	3.00	3.00
I.3.4	Semestri veror-ushtrime	1.5	3 lëndë	4.50	4.50
Shuma e pikëve të realizuara nga veprimtaria mësimore-arsimore					137.07

II. VEPRIMTARIA SHKENCORE- HULUMTUESE

Nr.Ren.	Emërtimi i aktivitetit	Pikët	Gjithsej
II.1	Punime shkencor me rezultate origjinale (burimore) shkencore, të botuar (publikuar) në revista shkencore-profesionale referente me këshill redaktues ndërkombëtar (6.0 x pjesëmarrja e autorit)		
II.1.1	Lindihana Goxha, Afrim Goxha, “Energy efficiency function of integrated photovoltaic modules into façade at Public Administration buildings“ Proceedings of the 3rd ICAUD International Conference in Architecture and Urban Design, Epoka University, Tirana, Albania, 24-26 October 2019, pp. 143-153	(6x0.9)=5.40	5.40
II.1.2	Lindihana Goxha, “How to renew the façade of educational buildings by using solar energy? ”, Journal Of Applied Sciences-State University Of Tetova (JAS-SUT), Vol. 5 / No. 9-10 / 2019, UDC 72/62/69, ISSN 1857-9930, pp. 55- 63	(6x1)=6.00	6.00
II.1.3	L.Goxha, “Renewed facade of educational buildings through integrated photovoltaic modules in a new double shell with energy efficiency function” Conference Proceedings, 14th International scientific conference on planning, design, construction and building renewal, INDIS 2018. Novi Sad, Serbia 2018 , pp 791 -798	(6x1)=6.00	6.00
II.1.4	L. Goxha, T.Samardzioska,: “Integrated active solar systems for energy efficient façade structures”, Scientific Journal of Civil Engineering • Volume 4 ,Issue 2 , Skopje ,December 2015 p.15-22	(6x0.9)=5.40	5.40
II.1.5	T. Samardzioska, A. Trombeva-Gavriloska, L. Goxha, “Active solar systems for energy efficient façade structures”, EASEC13, The Thirteenth East Asia-Pacific Conference on Structural Engineering and Construction, September 2013, Sapporo, Japan.	(6x0.8)=4.80	4.80
II.1.6	L. Goxha, T. Samardzioska, A.Trombeva: “The applikation of integrated active solar systems for energy efficient facade structures“, Conference Proceedings, 12th International scientific conference on planning, design, construction and building renewal, INDIS 2012. Novi Sad, Serbia 2012, p. 439 - 446	(6x0.8)=4.80	4.80
II.1.7	T. Samardzioska, A.Trombeva, E. Atanasovska,M. Larevska, L. Goxha, :“Energy efficient measures in MKD apartments”. Conference Proceedings 12th International scientific conference on planning, design, construction and building renewal, INDIS 2012. Novi Sad, Serbia 2012, p. 477- 489	(6x0.6)=3.60	3.60
II.2	Pjesëmarrje në takime shkencore- profesionale me referat- Prezantim oral (2.0 x pjesëmarrja e autorit)		

II.2.1	Lindihana Goxha, Afrim Goxha, “Energy efficiency function of integrated photovoltaic modules into façade at Public Administration buildings“ Certificate for oral presentation at 3rd ICAUD International Conference in Architecture and Urban Design, Epoka University, Tirana, Albania, 24-26 October 2019	(2x0.9)=1.80	1.80
II.2.2	Lindihana Goxha, “How to renew the façade of educational buildings by using solar energy? ”, Certificate for oral presentation at 5th International Scientific Conference on Applied Sciences, University of Tetova, 15 - 17 May 2019, Tetova, N. Macedonia	(2x1)=2.00	2.00
II.3	Abstrakte të botuar (publikuar) në përmbledhje të konferencave ndërkombëtare (1.0 x pjesëmarrja e autorit)		
II.3.1	Lindihana Goxha, Afrim Goxha, “Energy efficiency function of integrated photovoltaic modules into façade at Public Administration buildings“ Abstract Book, 3rd ICAUD International Conference in Architecture and Urban Design, Epoka University, Tirana, Albania, 24-26 October 2019, p.38	(1x0.9)=0.90	0.90
II.3.2	Lindihana Goxha, “How to renew the façade of educational buildings by using solar energy? ”, Abstract Book, 5th International Scientific Conference on Applied Sciences, University of Tetova, 15 - 17 May 2019, Tetova, N. Macedonia, p. 134	(1x1)=1.00	1.00
II.3.3	L.Goxha, “Renewed facade of educational buildings through integrated photovoltaic modules in a new double shell with energy efficiency function” Abstract Book, 14th International scientific conference on planning, design, construction and building renewal, INDIS 2018. Novi Sad, Serbia 2018 , p. 92	(1x1)=1.00	1.00
II.3.4	Lindihana Goxha, ”Određivanje modela niskoenergetskih zgrada s primjenom optimalnih rješenja korištenja fotonaponskih sustava integriranih u dvostruke fasade”, Doctoral Thesis Abstract, Znanstveni Časopis za Arhitekturu i Urbanizam, „Prostor” 26 [2018] 2 [56], University of Zagreb, Faculty of Architecture. Pp.32	(1x1)=1.00	1.00
II.3.5	L.Goxha, A.Goxha, “Optimal model of low energy buildings in northwest Macedonia using photovoltaic system integrated into a double façade”, Book of Abstracts, 2nd International Conference, “Towards Sustainable Development” – TSD2018, Skopje, N. Macedonia, 02 – 03 Dec. 2018, p. 31	(1x1)=1.00	1.00
Shuma e pikëve të realizuara nga veprimtaria shkencore- hulumtuese			44.70

III. VEPRIMTARIA PROFESIONALE – APLIKATIVE

Nr.Ren.	Emërtimi i aktivitetit	Pikët	Gjithsej
III.1.	Citime		
III.1.1.	2 (dy) herë citohen punimet e botuara të kandidatit	2.00	4.00
III.2	Veprimtaria profesionale artistike dhe aplikative		
III.2.1	PROJEKTE IDEORE- projektues përgjegjës (2)	(2 x 2.00)=4.00	4.00
III.2.2.	PROJEKTE KRYESORE (THEMELORE) - projektues përgjegjës (32)	(32 x 4.00)=128.00	128.00
III.2.3.	PROJEKT ZBATIMI- Inxhinjer realizimi (1)	(1 x 2.00)=2.00	2.00
Shuma e pikëve të realizuara nga veprimtaria profesionale-aplikative			138.00


IV. VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË


Nr.Ren.	Emërtimi i aktivitetit	Pikët	Gjithsejtë
IV.1	Anëtar i Këshillit Organizativ i Konferencës së parë ndërkombëtare të FSHZ-së ICAS 2015	1.00	1.00
IV.2	Anëtar i Këshillit Organizativ i Konferencës së dytë ndërkombëtare të FSHZ-së ICAS 2016.	1.00	1.00
IV.3	Anëtar i Këshillit Organizativ i Konferencës së pestë ndërkombëtare të FSHZ-së ICAS 2019	1.00	1.00
IV.4	Anëtar i Bordit Shkencor i Revistës Ndërkombëtare (JAS SUT) UDC 72 62 69 ISSN 1857-9930, Vol.6 No.9-10/2020	1.00	1.00
IV.5	Anëtar i Dhomës së Arkitektëve së Maqedonisë së Veriut	1.00	1.00
IV.6	Autorizime nga Dhoma e Arkitektëve së Maqedonisë së Veriut për: 1. Projektim, 2. Mbikqyrje 3. Realizim 4. Peojektim nga Efikasiteti Energjetik i objekteve ndërtimore	(4x1.00)	4.00
IV.7	Pjesëmarje në trajnim për Përgaditje Pedagogjike-Psikologjike dhe Metodike në kuadër të programit mësimor Pedagogji- Psikologji, SHHA, USHT, Tetovë, 2011	1.00	1.00
IV.8	Pjesëmarje në Seminarin me temë: Interneti dhe shërbimet online në përkrahje të mësimdhënies dhe mësimnxënies, UEJL, Tetovë, 2016	1.00	1.00
IV.9	Pjesëmarje në Punëtorinë: Aplikimi i metodave statistikore në hulumtim (SPSS), Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2019	1.00	1.00
IV.10	Pjesëmarje në trajnim për Kontrollë Energjetike, Shoqata MACEF, Qendra për Efikasitet Energjetik në Maqedoninë e Veriut, Shkup, 2015	1.00	1.00
Shuma e pikëve të realizuara nga veprimtaria me interes më të gjërë			13.00


REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE MËSIMORE -SHKENCORE		Pikët
I.	VEPRIMTARIA ARSIMORE-MËSIMORE	137.07
II.	VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	44.70
III.	VEPRIMTARIA PROFESIONALE- APLIKATIVE	138.00
IV.	VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJËRË	13.00
Totali i pikëve të realizuara		332.77

Tetovë, 14.12.2020

KOMISIONI RECENZUES:

4.Prof. Dr. Kujtim Elezi, kryetar 
(Universiteti i Tetovës, FSHZ, Prodekan për shkencë, R.M.V)

5.Prof. Dr. Violeta Nushi, anëtar 
(Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Arkitekturës, Dekan, Kosovë)

6. Doc. Dr. Nuran Saliu, anëtar 
(Universiteti i Tetovës, FSHZ, R.M.V)

Deri te:

KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR

FAKULTETI I SHKENCAVE TË ZBATUARA, UT-Tetovë

REFERAT I KOMISIONIT RECENZUES

Për zgjedhjen e një (1) asistenti për lëndët mësimore ne fushën e ndërtimtarisë, në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara të Universitetit të Tetovës-Tetovë

Në bazë të nenit 172 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, konkursi i shpallur për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore dhe në thirrje të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, **Fakulteti i Shkencave të Zbatuara, një (1) asistent për lëndët mësimore në fushën e arkitekturës;**

Në lidhje me konkursin e shpallur nga Universiteti i Tetovës për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore dhe ne thirrje e bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, të shpallur më **28.11.2020** në shtypin ditor “Koha” dhe “SllobodenPeçat” si dhe në web-faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit të Shkencave të Zbatuara, në mbledhjen e mbajtur më datë **07.12.2020**, solli Vendimin nr. **17-892/3** për formimin e Komisionit recensues në përbërje:

- 1. Doc. Dr. SHENASI ZEJNELI, kryetar,**
- 2. Prof. Dr. ENIS JAKUPI, anëtar,**
- 3. Doc. Dr. IDAVER HUSEINI, anëtar**

Në Konkursin e shpallur më datë **28.11.2020** në shtypin ditor “Koha” dhe “Sllobodenpeçat” si dhe në web-faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës është paraqitur vetëm një (1) kandidat dhe atë:

1. Mr. sc. Leart Taravari

Komisioni recensues, në përbërje si më sipër, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, paraqet këtë:

R A P O R T - R E F E R A T

Për zgjedhjen e një asistenti për lëndët mësimore në fushën e ndërtimtarisë, pranë Fakultetit të Shkencave të Zbatuara në Universitetin e Tetovës

1. Mr. sc. Leart Taravari

Kandidat-i në dosje ka dorëzuar dokumentet si vijon:

- Fletë aplikim;
- Diplomë për kryerjen e arsimit të lartë (fakultetin e ndërtimtarisë- ECTS 240) dhe marrjen e gradës ; Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë
- Diplomë për kryerjen e ciklit të dytë dhe marrjen e gradës shkencore magjistër i shkencave–fusha, Inxhinierisë së tërmeteve - ECTS 60;
- Certifikatë notash;Ciklit të parë(I) dhe të dytë (II)
- Marrëveshjet për angazhim par-tim në UT, Fakulteti i Shkencave të Zbatuara- Ndërtimtari.
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër (CV);
- punimin e magjistraturës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve dhe
- Certifikatën e shtetësisë.
- Vërtetim përregjistrim në ciklin e tretë (III)

I. Shënime biografike i kandidatit Mr. sc. Leart Taravari

Kandidati Leart Taravari është i lindur më 12 prill të vitit 1995, në Shkup, Republika e Maqedonisë. Shkollimin fillor e kreu në shkollën fillore “Ismail Qemali” në Gostivar, në vitin 2008 me sukses të shkëlqyeshëm kurse atë të mesëm e kreu në kolexhin “Jahja Kemal”, në Gostivar, në vitin 2012, gjithashtu me sukses të shkëlqyeshëm.

Është regjistruar në Fakultetin e Ndërtimtarisë në Shkup në vitin 2012, në programin studimor – ndërtimtari, drejtimi konstruktiv. Diplomo i në tetor të vitit 2016, me notë mesatare 9.90, me çka e fitoi titullin **Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë**.

Në tetor të vitit 2016, kandidati Leart Taravari është regjistruar në studime postdiplomike në Institutin për Inxhinieri të Tërmeteve dhe Inxhinieri Sizmologjike (IZIIS) në Shkup, në programin studimor – inxhinieria e tërmeteve. Kandidati i ka dhënë provimet e nevojshme, me notë mesatare 10.00. Më 12 maj të vitit 2020, kandidati me sukses e mbron temën e magjistraturës **“Kërkime eksperimentale dhe analitike në sjelljen seizmike të konstruksioneve betonarme me kat fleksibil”**, ku e fiton titullin **Magjistër i inxhinierisë seizmike**.

Në nëntor të vitit 2020, kandidati Leart Taravari regjistrohet në studimet e ciklit të tretë, në Fakultetin e Ndërtimtarisë në Shkup, në programin studimor – konstruksione, inxhinieria e tërmeteve.

II Përvoja profesionale

Nga tetori i vitit 2016, kandidati punon në firmë private ndërtimore në Gostivar. Ka marrë pjesë në projekte të shumta, faza statikë, në më shumë objekte banesore.

Në tetor të vitit 2017, kandidati angazhohet si bashkëpunëtor i jashtëm në Katedrën e Konstruksioneve të Betonit dhe Drurit, pranë Fakultetit të Ndërtimtarisë në Shkup.

Në tetor të vitit 2020, kandidati Leart Taravari angazhohet si (part-time) bashkëpunëtor i jashtëm në Lenden; e Konstruksioneve metalike 2, pranë FSHZ programi studimor Ndërtimtari në Universitetin e Tetovës.

Gjatë kësaj periudhe asistoi në lëndën; Konstruksionet metalike 2

Ka njohuri dhe eksperience ne këto programe:

AutoCad, Radimpex Tower, SAP2000, ROBOT Structural Analysis, Microsoft Office.

III Veprimtaria shkencore-hulumtuese

